



PJESA A: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 3 pikë

1. Katër letra gjenden në një rresht.



Cilin nga rastet A-E nuk mund ta arrini nëse lejohet të ndërroni pozitat e vetëm dy letrave?




2. Miza ka 6 këmbë. Merimanga ka 8 këmbë. Së bashku, 3 miza dhe 2 merimanga kanë këmbë po aq sa 9 pula dhe disa mace. Gjeni sa mace?

- (A) 2 mace (B) 3 mace (C) 4 mace (D) 5 mace (E) 6 mace

3. Alisa ka 4 pjesë të kësaj forme:



Cilën figurë nuk mund ta bëjë ajo prej këtyre 4 pjesëve?




4. Rrezja e di që $1111 \times 1111 = 1234321$. Sa bëjnë

$$1111 \times 2222?$$


- (A) 3456543 (B) 2345432 (C) 2234322 (D) 2468642 (E) 4321234

5. Në një planet ka 10 ishuj dhe 12 ura. Të gjitha urat janë të hapura për trafik. Sa është numri më i vogël i urave që duhen mbyllur për të ndaluar trafikun mes A dhe B.



- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5


6. Jane, Kate dhe Lyn nisen për rrugë. Jane është e para, Kate në mes dhe Lyn në fund. Jane peshon 500 kg më shumë se Kate. Kate peshon 1000 kg më pak se Lyn. Cila nga figurat e mëposhtme tregon Jane, Kate dhe Lyn në radhitjen e saktë?



7. Një zar i veçantë ka një numër në secilën faqe të tij. Shumat e numrave në faqet e kundërta janë të gjitha të barabarta. Pesë nga numrat janë 5, 6, 9, 11 dhe 14. Cili numër është në faqen e gjashtë?

- (A) 4 (B) 7 (C) 8 (D) 13 (E) 15

8. Elsa dëshiron të ngjyros katrorët e drejtkëndëshit ashtu që $\frac{1}{3}$ e të gjithë katrorëve të jetë e kaltërt dhe gjysma e të gjithë katrorëve të jetë e verdhë. Pjesa e mbetur e katrorëve do të ngjyrosset me ngjyrë të kuqe.









Sa katrorë do të ngjyrosen me ngjyrë të kuqe?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

9. Gjersa Petriti i zgjidh 2 detyra në garën "Kangaroo", Fisniku i zgjidh tri detyra. Të dy djemtë së bashku i zgjidhën 30 detyra. Sa detyra i zgjidhi Fisniku më shumë se Petriti?


- (A) 5 (B) 6 (C) 7 (D) 8 (E) 9

10. Bora palosi një letër, e përdori një shpuese vrimash dhe bëri saktësisht një vrimë në letër. Letra e shpalosur tregohet në figurën djathtas. Cila nga figurat e mëposhtme tregon vijat përgjatë të cilave Bora e ka palosur këtë letër?



PJESA B: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 4 pikë


11. Shitorja e Mobileve shet divan, kolltuk dhe karrige të ndërtuara nga pjesë identike siç tregohet në figurë. Duke përfshirë pushimoren e krahëve, gjerësia e divanit është 220 cm dhe gjerësia e foteles është 160 cm.



Sa është gjerësia e karriges?

- (A) 60 cm (B) 80 cm (C) 90 cm (D) 100 cm (E) 120 cm

12. 5 çelësa i përshtaten 5 drynjëve. Numrat në çelësa i referohen shkronjave mbi drynjë




Çka kishte të shkruar në çelësin e fundit?

- (A) 382 (B) 282 (C) 284 (D) 823 (E) 824

13. Fatoni shënoi të gjithë numrat prej 1 deri në 20 në një rresht dhe mori numrin 31-shifror: 1234567891011121314151617181920. Ai pastaj fshiu 24 nga 31 shifrat ashtu që numri që mbetet të jetë sa më i madh që është e mundur. Cilin numër e mori ai?

- (A) 9671819 (B) 9567892 (C) 9781920 (D) 9912345 (E) 9818192

14. Morea dëshiron që ndërtimin e mëposhtëm ta shndërrojë në kuti të rregullt. Cila nga kutitë vijuese është më e vogla që mund të arrijë ajo?



- (A) $3 \times 3 \times 4$ (B) $3 \times 5 \times 5$ (C) $3 \times 4 \times 5$ (D) $4 \times 4 \times 4$ (E) $4 \times 4 \times 5$

15. Kur mbledhim numrat në secilin rresht merren rezultatet që tregohen.

$$\begin{array}{|c|c|} \hline a & b \\ \hline c & d \\ \hline \end{array} \begin{array}{l} \rightarrow 2 \\ \rightarrow 3 \end{array}$$

$$\begin{array}{c} \downarrow \downarrow \\ 1 \quad 4 \end{array}$$


Cili pohim është i saktë?

- (A) a është baraz me d (B) b është baraz me c (C) a është më i madh se d (D) a është më i vogël se d (E) c është më i madh se b


16. Fatlumi u shëtiti në male për 5 ditë. Ai filloi të hënën dhe përfundoi të premten. Çdo ditë ai ecte 2 km më shumë se një ditë më parë. Kur shëtitja përfundoi, distanca që ai kishte kaluar ishte 70 km. Çfarë distance kaloi Fatlumi të enjten?

- (A) 12 km (B) 13 km (C) 14 km (D) 15 km (E) 16 km

17. Në trekëndëshin e parë në figurë është paraqitur kenguri. Vijat e ndërprera shërbejnë si pasqyrë. Pastaj janë treguar 2 reflektimet a para të figurës. Si duket reflektimi në trekëndëshin e hijezuar?



- (A) (B) (C) (D) (E)



18. Leotrimi ka një shumë të hollash dhe 3 shkopinj magjik të cilët mund t'i përdorë vetëm një herë.



Ky shkop magjik shton 1 EUR.




Ky shkop magjik heq 1 EUR.




Ky shkop magjik dyfishon shumën.

Në cilën renditje duhet të përdoren këta shkopinj magjik në mënyrë që të merret sasia më e madhe e të hollave?



19. Shkelzeni ka tre katrorë. Katrori i parë ka gjatësinë e brinjës 2 cm. Katrori i dytë ka gjatësinë e brinjës 4 cm dhe ka një kulm të tij të vendosur në qendrën e katrorit të parë. Katrori i fundit ka gjatësinë e brinjës 6 cm dhe ka një kulm të vendosur në qendrën e katrorit të dytë, siç tregohet edhe në figurë. Sa është syprina e sipërfaqes së figurës?



- (A) 32 cm^2 (B) 51 cm^2 (C) 27 cm^2 (D) 16 cm^2 (E) 6 cm^2


20. Katër lojtarë shënuan gola në një ndeshje hendbolli. Që të gjithë ata shënuan numër të ndryshëm golash. Nga të katërtit, Bashkimi shënoi më së paku gola. Tre të tjerët së bashku shënuan 20 gola.

Sa është numri më i madh i golave që mund të ketë shënuar Bashkimi?


- (A) 2 (B) 3 (C) 4 (D) 5 (E) 6

PJESA C: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 5 pikë

21. Shiriti përbëhet nga 2 kube të hirta dhe 1 kub i bardhë të bashkuar së bashku, siç tregohet në figurë.




Cila figurë mund të ndërtohet nga 9 shirita të tillë?



22. Numrat 1, 2, 3, 4, dhe 5 duhet të shënohen në pesë fushat e figurës në mënyrën vijuese:

- Numri duhet të jetë më i madh se numri nën të.
- Numri duhet të jetë më i madh se numri që është djathtas tij.



Në sa mënyra mund të plotësohet tabela?

- (A) 3 (B) 4 (C) 5 (D) 6 (E) 8

23. 8 kengura qëndrojnë në një rresht siç tregohet në figurë.



Në një moment, dy kengura që janë pranë njëri-tjetrit dhe që shikojnë njëri-tjetrin ndërruan vendet duke kërcyer njëri mbi tjetrin.

Kjo gjë u përsërit derisa nuk kishte mundësi tjera të kërcimit. Sa ndryshime u bënë gjithsej?


- (A) 2 (B) 10 (C) 12 (D) 13 (E) 16

24. Monika duhet të zgjedh 5 numra të ndryshëm. Ajo duhet të shumëzojë disa prej tyre me 2 dhe disa të tjerë me 3 në mënyrë që të marrë numrin më të vogël të rezultateve të ndryshme.

Sa është numri më i vogël i rezultateve që ajo mund të marrë.

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

25. Dyshemeja katrore në figurë është mbuluar me pllaka trekëndëshe dhe katrore, të hirta dhe të bardha. Sa është numri më i vogël i pllakave të hirta që duhet të ndërrohen me pllaka të bardha ashtu që modeli të duket njësoj nga të katër drejtimet e treguara ?



- (A) Tre trekëndësja, një katror (B) Një trekëndësh, tre katror
 (C) Një trekëndësh, një katror (D) Tre trekëndësja, tre katror
 (E) Tre trekëndësja, dy katror

26. Çanta përmban vetëm sfera të kuqe dhe të gjelbërta. Nga çdo 5 sfera që nxjerrim, së paku njëra është e kuqe; për 6 sfera që nxjerrim, së paku njëra është e gjelbërt. Sa është numri më i madh i sferave që mund të ketë në çantë?


- (A) 11 (B) 10 (C) 9 (D) 8 (E) 7

27. Jetës i pëlqejnë numrat çift, Besës i pëlqejnë numrat që plotpjesëtohen me 3, Lules i pëlqejnë numrat që plotpjesëtohen me 5. Secila prej këtyre 3 vajzave shkoi ndaras te shporta që kishte 8 topa me numra të shënuar në ta, dhe morën të gjithë topat me numrat që u pëlqejnë. Doli që Jeta mori topat me numrat 32 dhe 52, Besa - 24, 33 dhe 45, Lulja - 20, 25 dhe 35.

Në cilën renditje vajzat shkuan tek shporta?


- (A) Jeta, Lulja, Besa (B) Lulja, Besa, Jeta (C) Besa, Jeta, Lulja (D) Besa, Lulja, Jeta (E) Lulja, Jeta, Besa

28. Luani dëshiron të shënojë një numër natyror në secilën kuti të figurës ashtu që numri sipër të jetë shumë e dy numrave në kutitë nën të. Sa është numri më i madh i numrave tek që Luani mund të shënojë?



- (A) 4 (B) 5 (C) 6 (D) 7 (E) 8

29. Arbësa ka katër lapsa me ngjyra të ndryshme dhe dëshiron t'i përdor disa ose të gjithë lapsat për të ngjyrosur hartën e një ishulli të ndarë në katër kombe, siç tregohet në figurë.



Nëse hartat e dy kombeve me kufijtë e përbashkët nuk mund të ngjyrosen me ngjyrë të njëjtë tregoni në sa mënyra të ndryshme mund të ngjyrosë Arbësa hartën e ishullit?

- (A) 12 (B) 18 (C) 24 (D) 36 (E) 48

30. Në secilën fushë të tabelës me dimensione 6×6 gjendet një llambë. Themi se dy llamba në tabelë janë fqinje nëse ato gjenden në fusha me brinjë të përbashkët. Në fillim disa llamba janë të ndezura. Çdo minutë, secila llambë që ka së paku dy fqinjë të ndezur po ashtu ndizet. Sa është numri minimal i llambave që duhet të jenë të ndezura në fillim për t'u siguruar se pas një kohe të gjitha llambat do të jenë të ndezura?

(A) 4

(B) 5

(C) 6

(D) 7

(E) 8